



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:303544

Datë: 26.11.2024

Numri i dokumentit: 06509232

P.nr. 386/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me sekretaren juridike Fatmire Podvorica si procesmbajtëse dhe bashkëpunëtorin profesional Muhamet Musliu, në çështjen penale kundër të pandehurit A. A., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4734/2024, të datës 25.10.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 26.11.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Dardan Çelaj dhe i pandehuri, në të njëjtën ditë mori publikisht, shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

A. A., nga i ati Sh., dhe nëna F., e vajzërisë M., e lindur më..., me vendbanim në fshatin D. e P. komuna e P., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, e gjendjes të dobët ekonomike, i martuar baba i tre fëmijëve, me numër personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Prej datës së pavërtetuar deri me datë 14.11.2023, në shtëpinë e tij në fshatin D. e U. komuna e P., saktësisht në shtëpinë e tij, i pandehuri me qëllim siguron shërbime me energji elektrike për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe se shmangë pagesën për shërbime të tilla, edhe pse kishte qenë i shkyçur nga energjia elektrike për shkak të borxhit, ku gjatë kontrollit nga personat e autorizuar, është hasur që i njëjti ka bërë lidhje direktë në rrjetin elektrik jashtë pikës matëse, duke i bërë bashkë tri fazat e energjisë elektrike, në atë mënyrë që ka bërë anashkalimin te njëisorit elektrik me numër ..., ku energjia elektrike e shpenzuar nuk është matur, me të cilat veprime kompanisë KEDS-ës Divizioni i Rrjetit në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm material.

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore të neneve 4, 7, 17, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe nenit 314 KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 242, 364, 365, 369, 453, dhe 462 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

I. Me dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me gjobë në shumën prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë/euro), të cilin dënim i pandehuri nuk do ta paguaj nëse në afatin prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale.

II. Gjykata e liron të pandehurin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale, ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të pandehurit ose të personave që ai detyrohet ti mbështesë materialisht.

III. E dëmtuara: KEDS për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.4734/2024, të datës 25.10.2024, A. A., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata ka treguar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 26.11.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, të njëjtit në kuptim të nenit 241 par.4 të KPPRK-së i ofrojë mundësinë e deklaramit të tij rreth fajësisë-të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri me rastin e deklaramit të tij rreth fajësisë për veprën penale për të cilën është akuzuar, në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se: Se e pranojë fajësinë, është e vërtetë si ne aktakuzë, ky raste nuk do të përsëritet me asnjëherë, dëmin e shkaktuar do ti paguaj KEDS-se, lus gjykatën që të me shqiptoi një dënim sa me të lehtë sepse çfarëdo dënimi do të rendonte gjendje, time ekonomike, jam baba i 3 fëmijëve, gjendjen shëndetësore e kam të rënd .

Gjykata vërteton se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit Dardan Çelaj lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaron: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit , sepse i njëjti është bërë me vullnetin e plotë nga i pandehuri dhe bazuar ne shkresat e lëndës , me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit nga ana e gjykatës , gjykata të merr për bazë . rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese .

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par. 2 të KPPRK-së, aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri në shqyrtimin fillestar, andaj konform nenit 242 par. 6 të KPPRK-së vazhdoi me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i pandehuri, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit përmbushen të

gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin e paraparë ligjor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ka premtuar se më nuk do ta përsëris veprën ndërsa si rrethana rënduese nuk gjeti, andaj Gjykata vlerësoi se dënimi me kusht i shqiptuar është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 të KPRK-së, e që është risocializimi i të pandehurit me anë të pezullimit të dënimit, me të cilin dënim të pandehurit i tërhiqet vërejtja seriozisht dhe i bëhet me dije se nëse i njëjti kryen veprë tjetër penale brenda periudhës së verifikimit të përcaktuar si në pikën (I) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Vendimi mbi lirimimin nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në bazë të nenit 452 par. 4 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, për shkak se gjykata nuk ka pasur ndonjë ekspertizë nga ndonjë ekspert i pavarur për vlerësimin e dëmit, andaj mbi këtë bazë është udhëzuar në kontest civil, pasi që gjykata nuk ja fali besimin, vlerësimin e dëmit vetëm nga pala e dëmtuar për shkak se nuk paraqet bazë të sigurt për gjykim.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr. 386/24, dt. 26.11.2024

Sekretare juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.